



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në bazë të neneve 12.2, shkronj(d), 12.1, nenit 17 shkronja (b), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40 (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt. 04.06.2008), neni 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.2, neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, nenit 10 paragrafi 2, pika 2.2 dhe nënpika 2.2.2, nenit 11 dhe nenit 16 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013" dhe Udhëzimit Administrativ MMPH –NR. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartave Zonale Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-2032 Njësia Org.SP-02; Nr.prot.6358-2/24 Dt.08.11.2024 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, neni 72 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 dt.25.04.2016, neni 39 të Regullores së Punës së Kuvendit nr.I-95, të dt. 29.06.2018, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga Drejtoria për Planifikim Urban Kadastër dhe Pronë (DPUKP) të datës 08.11.2-24 në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur me dt.15.11.2024 mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032

Neni 1

MIRATOHET Vendimi për dokumentin e Planifikimit Hapësinor- Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032 për periudhën 8 (tetë) vjeqare, si një projekt –plan multi-sektorial i cili përcakton zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë teritorin e komunës, e cila do të krijoj bazat e qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Neni 2

2.1. Harta Zonale e Komunës është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës,

2.2 Pjesë përbërse e këtij vendimi të Kuvendit është “Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032” e hartuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë si bartëse e procesit duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.30/2013” , Udhëzimin Administrativ MMPH –NR. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartave Zonale të komunave, Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për normat teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Vendimi për dhënien e pëlqimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Obiliqit 2024-2032 Njësia Org.SP-02; Nr.prot.6358-2/24 Dt.08.11.2024 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës .

2.3.”Harta Zonale e Komunës së Obiliqit 2024-2032” në vete përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Vendimin Nr.Prot.5380-2/23 Dt.08.02.2024 për Pëlqimin Mjedisor për raportin e vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Obiliqit dhe Raportin e Shqyrtimit Publik të cilat po ashtu janë pjesë përbërse të këtij vendimi .

Neni 3

Pas miratimit të këtij vendimi për zbatimin e tij do të kujdesen të gjitha organet e komunës së Obiliqit nën mbikqyrjen e Drejtorisë së Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës .

-T’i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- MAPL
- DPUPK-së
- Arkivit

